

ALBANIAN WATER PARTNERSHIP

1. Informacion Bazë

- Viti i Themelimit: 14.11.2024
- Statusi Ligjor: Organizatë Jofitimprurëse
- Selia Qendrore: Shyqyri Berxolli, Ap. Nr. 21 A, numer pasurie 6 472+2-6, Tiranë, Shqipëri
- Faqja e Internetit: <https://albanianwaterpartnership.org/>
- Email kryesor i organizatës: awp@albanianwaterpartnership.org
- Telefoni kryesor i organizatës: +355685890767

2. Misioni

Albanian Water Partnership (AWP) adreson në mënyrë të drejtpërdrejtë sfidat e menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve ujore në Shqipëri. Organizata promovon përdorimin efikas, të balancuar dhe të përgjegjshëm të ujit, në përputhje me direktivat dhe standardet evropiane, duke ndjekur një qasje ndërsektoriale dhe të integruar që sjell përfitime afatgjata për komunitetet dhe mjedisin.

Misioni i AWP është të përmirësojë menaxhimin e burimeve ujore përmes zbatimit të qasjes NEXUS, parimeve të ekonomisë qarkulluese, zgjidhjeve të bazuara në natyrë dhe infrastrukturës së gjelbër-gri. AWP promovon edukimin dhe ngritjen e kapaciteteve, angazhimin e palëve të interesuara, bashkëpunimin me universitete dhe institucione kërkimore, si dhe promovimin e teknologjive dhe praktikave inovative që mbështesin zhvillimin e qëndrueshëm.

3. Vizioni (Opsionale)

Vizioni ynë është një Shqipëri me burime ujore të sigurta, ku uji menaxhohet në mënyrë të qëndrueshme, efikase dhe të barabartë, dhe ku përfitimet maksimizohen për të gjithë aktorët, në harmoni me mjedisin dhe ekosistemet. Ne parashikojmë një të ardhme ku kërkimi shkencor dhe edukimi luajnë një rol jetik në informimin e praktikave të menaxhimit të ujit, dhe ku të gjithë aktorët, përfshirë përdoruesit e ujit dhe komunitetet, janë të angazhuar aktivisht në procesin e vendimmarrjes, për të siguruar mbrojtjen e mjedisit dhe sigurinë e burimeve ujore.

Gjithashtu, synojmë të promovojmë konceptet e menaxhimit të “ujërave të gjelbëra”, të cilat kanë një rol të pazëvendësueshëm për zhvillimin bujqësor dhe ruajtjen e biodiversitetit, dhe “ujërave blu”, që lidhen me rezervat ujore në dispozicion, ku uji përdoret dhe menaxhohet në një mënyrë që mbështet shëndetin e ekosistemeve dhe ciklin natyror të ujit.

4. Fushat Kryesore të Fokosit

- Menaxhimi i integruar i Burimeve Ujore
- Ekonomia Qarkulluese dhe Përdorimi Efikas i Ujit
- Qasja NEXUS: Ujë–Energji–Ushqim–Ekosisteme
- Zgjidhjet e Bazuar në Natyrë dhe Infrastruktura Gjelbër–Gri
- Edukimi, Ndërgjegjësimi dhe Fuqizimi i Komuniteteve
- Mbështetja e Zbatimit të Direktivave të BE-së dhe Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG)
- Mbrojtja e Mjedisit
- Konservimi natyror
- Zbutja dhe Përshtatja ndaj Ndryshimeve Klimatike: Përmbytje dhe Thatësira

ALBANIAN WATER PARTNERSHIP

- Advokimi për transparencë dhe përgjegjshmëri në politikbërje

5. Aktivitetet/Programet Kryesore

Si një organizatë e sapothemeluar, AWP ka përcaktuar disa fusha prioritare për veprim në fazën e parë të zhvillimit të saj. Programet kryesore të planifikuara përfshijnë:

- Knowledge Hub & Rritja e Kapaciteteve – Krijimi i një qendre të hapur për ndarjen e praktikave më të mira, trajnime për përdoruesit e ujit, sektorin privat dhe institucionet publike;
- Zgjidhje të Bazuar në Natyrë dhe Infrastrukturë Green-Grey – Promovimi i metodave të qëndrueshme për trajtimin e ujërave dhe përmirësimin e cilësisë së tyre përmes ndërhyrjeve të integruara;
- Edukim dhe Ndërgjegjësim – Aktivitetet për rritjen e ndërgjegjes publike mbi çështjet e menaxhimit të qëndrueshëm të ujit, ndryshimet klimatike dhe rolin e komunitetit në mbrojtjen e mjedisit.
- Dokumente Strategjike dhe Plane Menaxhimi – Hartimi dhe mbështetja në zbatimin e strategjive, planeve menaxhuese dhe dokumenteve të tjera udhëzuese që ndihmojnë në menaxhimin e integruar të burimeve ujore dhe përafrimin me legjislacionin e BE-së.

6. Shtrirja Gjeografike

AWP është një organizatë me fokus kombëtar, që synon të veprojë në të gjithë territorin e Shqipërisë. Në fazën fillestare, ndërhyrjet dhe bashkëpunimet janë të përqendruara në zona me sfida të theksuara të menaxhimit të ujit, si basenet lumore, zonat bregdetare, dhe komunitetet rurale me akses të kufizuar në shërbime ujore. Në të ardhmen, AWP synon të zgjerojë shtrirjen edhe në nivel ndërkufitar përmes partneriteteve rajonale.

7. Udhëheqja

Drejtori Ekzekutiv: Znj. Lorela Lazaj

Bordi i Drejtuesve: Znj. Ornela Shoshi, Z. Arben Pambuku, Z. Vartkes Piranjani.

8. Partneritetet dhe Bashkëpunimet

AWP është pjesë e Climate Bridges Network, një rrjet evropian që promovon veprimin klimatik, ekonominë qarkulluese dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore në Ballkanin Perëndimor. Gjithashtu, jemi në proces partneriteti me Global Water Partnership, për të forcuar bashkëpunimin rajonal dhe qasjen e integruar në menaxhimin e ujit në përputhje me SDG-të dhe direktivat e BE-së.